

REVISTA JURIDIKE SHQIPTARE

LUFTA KUNDËR INFORMALITETIT -
NEVOJA PËR NJË STRATEGJI
NDËRSEKTORALE DHE NGRITJA E
STRUKTURAVE TË PËRSHTATSHME ME
FOKUS INFORMALITETIN NË TREGUN E
PUNËS

Evis Fico



Financuar nga
Bashkimi Evropian



PUBLIKUES

Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA)
Rr. Milto Tutulani, Nd.1, Ap. 3. (Dora D'Istria)
Tel: +355 44 104 247
E-mail: info@em-al.org
Web: www.em-al.org

AUTORË**Evis Fico****VITI I PUBLIKIMIT****korrik 2024**

Ky material është prodhuar në kuadër të projektit “Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE”, me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Lëvizjes Europiane në Shqipëri, Revistës Juridike Shqiptare dhe autorëve, dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet dhe qëndrimet e Bashkimit Evropian.

Projekti "Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE", po zbatohet nga Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian - IPA Civil Society Facility and Media 2021, në bashkëpunim me Akademinë e Integritit Evropian dhe Negociatave (AIEN), Slovak Foreign Policy Association (SFPA) dhe Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë (CTFI)



Financuar nga
Bashkimi Evropian



Hyrje - Situata aktuale	03
Reduktimi i ekonomisë informale - Fiskalizimi dhe Regjistrat Dixhitalë	04
Vlerësimet dhe Rekomandimet e Raportit vjetor të Komisionit European	05
Problematika dhe Rekomandime	07
REFERENCA	11

Lufta kundër korrupsionit, pastrimit të parave dhe rritja e integritetit në administratën publike tashmë nuk është vetëm një nga objektivat e Qeverisë Shqiptare, por është përcaktuar si një angazhim që prek raportimet e Shqipërisë përballë ekipeve të Bashkimit Europian si për kapitujt 23-24[1], ashtu edhe gjatë gjithë procesit screening[2]. Pjesë integrale e këtij angazhimi është veçanërisht lufta ndaj fenomenit të informalitetit, siç është ai në tregun e punës. Padyshim ka vite që flitet e punohet për të, por ende mbetet një mision i vështirë i cili nuk i takon vetëm shtetit, por çdo qytetari.

Situata aktuale flet për institucione drejtësie të reformuara të cilat me qëndrimin ndëshkues kanë filluar të japin rezultate konkrete në luftën kundër korrupsionit, kur ekzekutivi ende vijon në frymën e qasjes ndërjegjësuere e parandaluese. Shteti shqiptar ka ndërmarrë nisma për të luftuar korrupsionin dhe informalitetin, përmes një sërë reformash, si:

- Reforma në Drejtësi;
- Reforma në Sektorin Financiar përmes fiskalizimit dhe fuqizimit të mekanizmave të kontrollit përmes dixhitalizimit;
- Reforma në Administratën Publike përmes rritjes së transparencës dhe integritetit të punonjësve të saj si dhe bashkëpunimit qeveri – biznes.

Të gjitha këto në funksion të një qëllimi, luftës kundër korrupsionit dhe informalitetit në tregun e punës, duke theksuar qëllimi kryesor është t'i shërbejë qeverisjes së mirë të bizneseve, si dhe reduktimit të metodës korruptuese në disa aspekte në luftën kundër evazionit dhe informalitetit[3].

Informaliteti është një nga pengesat kryesore për zhvillimin e qëndrueshëm të bizneseve formale dhe rrjedhimisht për ekonominë e vendit në përgjithësi. Faktorë të rëndësishëm që ndikojnë në mjedisin e biznesit lidhen me:

1.ndryshimet e shpeshta në legjislacion, shpeshherë të pakuptueshme për bizneset kryesisht të vogla;

2.tendencat në rritje të normave të interesit që e bëjnë kreditimin më të shtrenjtë;

3.faktorë të tjerë që ndikojnë në një klimë të pafavorshme për biznesin si:

- pasiguria e përgjithshme si pasojë e rritjes së çmimeve,

- rritja e kostos së blerjes së lëndëve të para (sektorët e prodhimit) dhe

- rritja e çmimeve të produkteve të tregtuara (sektorët e tregtisë);

4.konkurrenca joformale e cila penalizon bizneset që nuk varen nga këto burime.

Sipas raportit të Departamentit Amerikan të Shtetit (DASH) për Shqipërinë, të punësuarit në sektorin informal përbëjnë 57% të ekonomisë, referuar përmbledhjes së Organizatës Ndërkombëtare të Punës për vitin 2019. Ndërkaq referuar vlerësimit të Komisionit Europian mbi programin e reformave ekonomike theksohet se: Pesha e punësimit informal ka kapur vlerën 36.2%[4]në vitin 2020, e barabartë në nivelet e vitit 2017, dhe në sektorin e bujqësisë 48.7%.

Reduktimi i ekonomisë informale - Fiskalizimi dhe Regjistrat Dixhitalë

Në luftën kundër informalitetit ka ndihmuar më së shumti një nga reformat më revolucionare në aspektin dixhital dhe ekonomik siç është fiskalizimi, i cili nisi si iniciativë në vitin 2019[5] me qëllim raportimin në kohë reale të informacionit tatimor dhe monitorimin e qarkullimit të transaksioneve me dhe pa para në dorë në Republikën e Shqipërisë, si dhe monitorimin e mallit në lëvizje. Procesi i fiskalizimit si një reformë madhore e ndërmarrë nga administrata tatimore ka mundësuar deklarimin dhe ndjekjen në kohë reale të transaksioneve të shitblerjeve të kryera nga popullsia e tatimpaguesve. Ky proces ka ndihmuar në uljen e informalitetit dhe rritjen e saktësisë së deklarimit nga subjektet që bëjnë deklarimet reale financiare të aktivitetit të tyre ekonomik, por gjithsesi mbetet një sfidë, pasi disa biznese do të vazhdojnë me faturimet dhe nëndeclarimet informale, duke qëndruar sërish si pjesë e “ekonomisë gri”. Kështu vihet re, që të ardhurat nga TVSH-ja për periudhën janar - korrik 2023, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2022, janë rritur me 20% falë administrimit të mirë fiskal dhe procesit të fiskalizimit[6].

Fiskalizimi targeton:

- Ulje të informalitetit, përmirësim të kontrollit tatimor dhe verifikimit në terren
- Mbledhje më të mirë të tatimeve në shkallë vendi, ku zëri kryesor mbetet Tatimi mbi Vlerën e Shtuar, dhe
- Angazhim qytetar.

Të gjitha këto sjellin më pak burokraci, dhe luftë kundër korrupsionit përmes rritjes së transparencës së të bërit biznes pasi

informaliteti pengon jo vetëm zhvillimin e atyre bizneseve që vendosin të mbeten informale, por është gjithashtu, një pengesë për kompanitë formale që ndeshen me konkurrencën e pandershme nga sektori informal. Sipas Anketës e së Performancës së Mjedisit të Ndërmarrjeve (BEEPS), theksohet se pothuajse një e treta e transaksioneve kanë një aspekt informal: “44.7% e kompanive raportuan se janë duke u konkurruar nga konkurrentë informalë. Kjo nënkupton që ekonomia informale vazhdon të kufizojë ekonominë e Shqipërisë.”

Në dhjetor të vitit 2021 u ngrit me Urdhër të Kryeministrit “Njësia Informalitet”, me synim evidentimin e atyre sektorëve të tatimpaguesve të cilët prezantojnë risk dhe dukshëm nuk deklarojnë nivelin e pagave, krahasuar me sektorë të tjerë. Rrjedhja e të dhënave të pagave të rreth 630 000 qytetarëve në vitin 2021 i mundësoi njësisë së posaçme kundër informalitetit të shënjestronte praktikën e përhapur të nën-raportimit të pagave në nivel biznesi individual dhe autoritetet tatimore përsëritën thirrjen e tyre për bizneset dhe të vetëpunësuarit për të korigjuar deklaratat e tyre përkatëse të të ardhurave. Këto masa reduktuan ndjeshëm numrin e punonjësve që merrnin pagën minimale (rreth 243 euro) dhe kontribuan në rritjen statistikore të pagave[7].

Kjo njësi pas kontrolleve të kryera vërejti:

- a) mangësi në elementet e kontratave të punës, si specifikimet për elemente të pagës, apo elemente në disfavor të punëmarrësve në një nivel të lartë për një subjekt (afro 50% e punëmarrësve të kontrolluar)
- b) fenomenin e dhënies së pagave jashtë sistemit bankar apo punonjës të padeklaruar veçanërisht në sektorët e ndërtimit, tregtisë, sigurimit etj.

Sipas të dhënave të bëra publike në fillim-vitin 2022 në sektorin e sigurimeve ka pasur shumë devijime për deklarimin e pagës. Gjithashtu janë evidentuar fenomene të dhënies së pagës në formë bonusi, por që lidhet me kompensimin e pagës.

Sikundër u theksua më lart transparencja mbi pronarët përfitues dhe llogaritë bankare konsiderohet si mjet kyç në luftën kundër evazionit fiskal, korrupsionit dhe flukseve të paligjshme financiare, me theks të veçantë tek pastrimi i parave. Kështu me krijimin dhe konsolidimin e Regjistrave dixhitalë të pronarit përfitues dhe llogarive bankare përgjatë vitit 2021, u vendos një bazë solide për të shmangur anonimat në pronësi, për të siguruar prova për pasuri të pashpjegueshme, si dhe për të ofruar terren për verifikim pranë organeve ligjzbatuese. Regjistri i llogarive bankare menaxhohet nga administrata tatimore, ndërsa regjistri i pronarëve përfitues administrohet nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), të dy këta regjistra të ngritur nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI).

Vlerësimet dhe Rekomandimet e Raportit vjetor të Komisionit European

Vlerësimet e rekomandimet e Raportit vjetor të Komisionit European (KE) për Shqipërinë 2023 tregojnë se në lidhje me kapacitetin për të përballuar presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda BE-së, Shqipëria ka bërë njëfarë progresi dhe ka një nivel përgatitjeje[8]. Gjithashtu vlerësohet që konkurrueshmëria e Shqipërisë pengohet nga disa faktorë si: - mungesa e njohurive sipërmarrëse dhe teknologjike, -nivele të konsiderueshme informaliteti, -nevoja të paplotësuar për

investime në kapitalin njerëzor e fizik, si nevoja për shpenzime të vazhdueshme për Kërkim dhe Zhvillim.

Sipas Raportit të Komisionit European 2023[9], në Shqipëri ka përmirësim të shërbimeve mbështetëse të biznesit, siç janë:

1.mekanizmat e konsultimit me bizneset dhe partnerët socialë dhe bashkëpunimi me ta për zhvillimin e një plani strategjik veprimi për zbatimin e politikave kundër informalitetit. Këtu duhet theksuar se Këshilli i Investimeve që kryesohet nga Ministri i Financave ka në fokus bashkëpunimin për plan strategjik veprimi për zbatimin e politikave kundër informalitetit ku dhe në axhendën e tij të 15 Dhjetor 2023 trajtoi draft Programin e Reformave Ekonomike (ERP) 2023-2025. Ndër të tjera në raport theksohet, që masat për reduktimin e aktiviteteve të biznesit informal dhe korrupsionit kanë dhënë rezultate edhe pse me ndikim të kufizuar në mjedisin e biznesit. Ndër të tjera theksohet që: “Shqipëria ka bërë njëfarë progresi dhe ka një nivel përgatitjeje për të përballuar presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda BE-së”.

Raporti në përfundim ofron dhe disa rekomandime që duhet të merren në konsideratë për tu realizuar deri në vitin e ardhshëm, ku në veçanti theksohet që Shqipëria duhet:

- Të adresojë sfidat kryesore për mjedisin e biznesit: - duke ulur barrën rregullatore, - duke rritur pjesëmarrjen në programet e financimit të disponueshëm për bizneset, - duke forcuar përpjekjet për të luftuar informalitetin dhe korrupsionin, - duke rritur shërbimet e mbështetjes së biznesit, dhe të ligjit për bizneset fillestare.

- Të përshpejtojë harmonizimin e plotë të legjislacionit kombëtar me acquis të BE-së për pagesat e vonuara.
- Të miratojë ligjin e unifikuar të investimeve
- Të adresojë sfidat ndaj konkurrencës dhe rritjes, siç theksohet në rekomandimet e përbashkëta të EPR 2022-2024.

Ndihet nevoja për hartimin e një strategjie gjithëpërfshirëse të luftës kundër informalitetit e cila asnjëherë nuk ka qenë në formë strategjie të mirëfilltë, por është drejtuar nga institucione të ndryshme. Kjo strategji e re do të kërkojë angazhimin e të gjithë strukturave shtetërore relevante të përfshira në të. Me anë të saj duhet të synohet ngritja e një strukture permanente të vlerësimit të riskut në funksion të kontrollit inteligjent të evazionit dhe informalitetit në varësi të Ministrisë së Financave. Kjo strukturë synohet të mbledhë, përpunojë, analizojë informacionin me rëndësi nga të gjitha burimet e mundshme për të goditur efektivisht rastet e evazionit dhe të kontrabandës.

Një vëmendje të veçantë duhet të marrë informaliteti në tregun e punës. Nga shtyllat e përmendura për luftën kundër korrupsionit e më konkretisht në luftën kundër informalitetit, lidhur me nevojën për një strategji dhe ngritjen e strukturave, është vlerësuar me interes fokusi tek informaliteti në tregun e punës. Në këtë kontekst qeveria shqiptare më 31 Janar të vitit 2022 miratoi Programin e Reformave Ekonomike (ERP) 2022–2024[10], ku ndër rekomandimet e nxjerra është edhe Rekomandimi 4.3 që ka në fokus Hartimin dhe konsultimin e një strategjie gjithëpërfshirëse për të trajtuar dhe mbikëqyrur të gjitha aspektet e informalitetit, me një plan veprimi me 'baselines', duke përfshirë objektiva të qartë dhe të matshëm dhe për të vendosur një monitorim të rregullt të bazuar në ecurinë e zbatimit dhe rezultateve të tij.

Për zbatimin e këtij rekomandimi, gjatë periudhës dyvjeçare, përpjekjet e Administratës

Tatimore Shqiptare për të luftuar informalitetin do duhet të përqendrohen në kriteret e reja dhe të përmirësuara të riskut për identifikimin e tatimpaguesve në mospërbushje të detyrimeve tatimore (ku përfshihen tatimpaguesit me rritje të të ardhurave, por ulje të detyrimit TVSH; tatimpaguesit që nuk deklarojnë shpenzimet për faturat e energjisë elektrike; tatimpaguesit me paga të nën-deklaruara për punonjësit e tyre – të identifikuar duke krahasuar të dhënat disavjeçare).

Gjithsesi, bazuar në vlerësimin e KE për ERP 2022-2024 kjo masë mbetet ende e paplotësuar. Në seksionin 5.2.4 të ERP-së për mjedisin e biznesit dhe ekonominë informale, analiza e pengesave sipas këtij seksioni kufizohet në ekonominë informale, ekspozimin e bizneseve ndaj aspekteve të ndryshme të ekonomisë informale dhe disa praktikave korruptive që mundësojnë 'formalizimin' e veprimeve joformale. Sipas vlerësuesve ky seksion nuk është gjithëpërfshirës dhe as nuk analizon çështje të tjera të shumta që ndikojnë në mjedisin e biznesit siç janë: ndryshimet e shpeshta të legjislacionit përkatës, konsultim i dobët i teksteve ligjore në fazën e hartimit, zbatim i dobët të kontratave dhe çështje që lidhen me sistemin ligjor dhe pronën e të tjera.

Ndërsa ERP për 2022-2024 përshkruan çështjet e shkaktuara nga ekonomia informale dhe angazhimin e institucioneve shqiptare për "qeverisjen e mirë të biznesit" dhe për uljen e korrupsionit, ai nuk përcakton se çfarë është "qeverisja e mirë e biznesit" apo të përshkruaj sfida të tjera ndaj mjedisit të biznesit.

Megjithatë, ai përcakton sesi shteti synon të trajtojë ekonominë informale, të cilën e ka identifikuar si penguese të konkurrencës së ndershme dhe që ndikon në ulje të të ardhurave për buxhetin e shtetit.

Gjithashtu, është evidentuar që analiza e sektorit nuk është përditësuar – ajo ende i referohet vitit 2020, COVID-19 dhe ndikimit negativ të pandemisë në sektorë të veçantë për sa i përket Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB). Analiza duhet të ishte për vitin 2021, kur Shqipëria pati rritje pozitive. Për më tepër, një analizë e performancës së sektorit mund të ishte përfshirë, megjithëse referenca e bërë në anketën e Sekretariatit të Këshillit të Investimeve mbi ndikimin e COVID-19 tek bizneset është e mirëpritur. Megjithatë, një vlerësim më i mirë dhe më i plotë i klimës së biznesit do të kishte informuar më mirë analizën dhe, potencialisht, mjetet për të trajtuar ekonominë informale, e cila lidhet me pikën tjetër.

Së dyti, lufta kundër pastrimit të parave është një nga prioritetet dhe detyrat e performancës së çdo autoriteti publik përgjegjës, e paraqitur në çdo raportim që bëhet nga Task Forca e Veprimtarisë Financiare (FATF) dhe nga Komisionin European në procesin screening. Gjithsesi, është me rëndësi të theksohet që korrupsioni dhe pastrimi i parave nuk mund të luftohen dhe ndalohen vetëm përmes qasjes ndëshkuese, por kërkohet një punë afatgjatë e ndërsektorale për një administratë publike moderne dhe punonjës me integritet. Për këtë qëllim për herë të parë Ministria e Drejtësisë në 2020 hartoi planet e integritetit të cilat u referuan dhe si model për institucionet e tjera zyrtare. Planet e integritetit ndjekin formësimin e zyrtarit me etikë dhe njohuri në fushën e luftës kundër korrupsionit. Gjithsesi vlerësohet që, del në pah nevoja për hartimin e një

dokumenti incentivash në sektorët më nevralgjikë si dogana, tatimet, shëndetësia, pronat. Këto incentiva do t'i shërbejnë më shumë mirëqeverisjes dhe llogaridhënies duke rritur besimin tek qytetarët dhe duke luftuar informalitetin.

Disa masa që po ndërmerren sa i përket trajtimit të evazionit fiskal, mashtrimit fiskal dhe informalitetit, lidhen si fillim me përdorimin në kohë reale të mbikëqyrjes së transaksioneve financiare midis tatimpaguesve, sipas sistemit të sapozbatuar të fiskalizimit (sistemi i monitorimit dhe mbikëqyrjes së veprimtarive tregtare të tatimpaguesve nga autoritetet tatimore shqiptare). Ky sistem do të sjellë më shumë raportime transaksionesh me para në dorë dhe do të reduktojë transaksionet e fshehura pa para, me kontroll më të mirë të sistemit fiskal. Do të ndihmojë, gjithashtu, efikasitetin në raportimin fiskal, duke mbledhur më shumë të dhëna nga tatimpaguesit dhe duke parambushur deklaratën e TVSH-së me këto të dhëna.

Një masë tjetër lidhet me detektimin e të ardhurave globale të padeklaruara nga tatimpaguesit dhe individë, nëpërmjet shkëmbimit të parë automatik të informacionit mbi llogaritë financiare, sipas standardit të përbashkët të raportimit të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) [11].

Gjithashtu me rëndësi është edhe Integrimi dhe përdorimi i të dhënave nga palët e treta në data warehouse (magazinë të dhënash) të administratës tatimore, {autoritetet kombëtare të shërbimeve (uji, elektriciteti), regjistrimi i automjeteve, bashkitë etj.}. Duke marrë në konsideratë hendekun e TVSH-së, si dhe

mospërputhjet e të dhënave, mbledhjen e të dhënave dhe administrimin e mirë të tyre, ndërtimi i një data warehouse (si një nga rekomandimet e FMN-së) me të dhëna të centralizuara, të menaxhuara nga vetëm një burim, mund të vlerësohet që kjo do të bëhet një hap i madh përpara në lidhje me luftën kundër informalitetit.

Ndërtimi i Regjistrimit të Aseteve të Tatimpaguesve (të tundshme dhe të patundshme), me qëllim vlerësimin real të pasurive të tatimpaguesve, duke ndërtuar një sistem për verifikimin dhe ndjekjen e të ardhurave të tatimpaguesve, kontrollin e plotë të pagesave të bëra mbi taksat e pasurisë është një tjetër masë që po ndërmerret dhe duhet të sjellë rezultatet e pritshme. Është parashikuar që ky proces do të kalojë nëpër 3 faza: a) krijimi i një regjistri asetesh me atributet përkatëse; b) shkëmbimi i të dhënave me shërbimet online (web-service); c) analiza e të dhënave me raportet BI.

Shumë masa dhe aktivitete përshkruhen hollësisht në seksionin Masat e Reformës O6: Forcimi i luftës kundër informalitetit, ku mund të përmenden: - Hartimi dhe zbatimi i një programi përmbushjeje për individët më të pasur, -Fuqizimi i sistemit dhe përdorimi i të dhënave në procesin e vendimmarrjes, në lidhje me individët e pasur, -Përdorimi i qasjes së integruar për zbatimin e strategjisë së përmbushjes së individëve të pasur, -Analiza dhe zbatimi i rregullave të riskut për monitorimin e tatimpaguesve, në kuadrin e ndryshimit të pragut të TVSH-së në 10 milionë lekë, -Zbatimi i planit sektorial të informalitetit në tregun e punës në 4 komponentët e tij.

Sa i përket masë së fundit lidhur me planet sektoriale, duhet theksuar që administrata tatimore ka marrë në mënyrë të vazhdueshme masa ndaj luftës kundër informalitetit. Nëpërmjet planeve sektoriale administrata tatimore synon të identifikojë sektorë me risk në ekonomi dhe të hartojë plane për të luftuar informalitetin në fushat që kanë ndikim më të madh në ekonomi, si nëndeklarimin e pagës reale apo mosdeklarim korrekt të numrit të punonjësve duke u realizuar nëpërmjet të dhënave që disponon administrata tatimore nga sistemet informatike tatimore apo duke evidentuar ata tatimpagues që më parë kanë pasur një historik mospërmbushjeje të detyrimeve tatimore.

Qëllimi kryesor është përmirësimi i kuadrit bashkëpunues ndërinstitucional dhe sigurimi e i planeve operacionale për të identifikuar punonjësit informalë, duke u mbështetur në një strategji të qartë. Duhet theksuar që përgjegjësia për trajtimin e punës së padeklaruar është e përhapur në disa institucione: mospërmbushja e detyrimeve tatimore lidhet direkt me administratën tatimore, trajtimi i kontributeve lidhet me Institutin e Sigurimeve Shoqërore (ISSH) dhe respektimi i Kodit të Punës mbikëqyret dhe monitorohet nga Inspektorati i Punës. Në vijimësi parashikohet të forcohet bashkëpunimi me njësinë e riskut të Zyrës së Punës, për të garantuar një marrëveshje bashkëpunimi, me qëllim shkëmbimin e informacionit ndërmjet këtyre institucioneve[12].

Administrata tatimore disponon të dhëna më cilësore për tatimpaguesit, që më pas do t'i vendosen në dispozicion dhe zyrës së punës

apo dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Këto masa pritet të sjellin reduktim të punës së padeklaruar dhe të nëndeklarimeve të ekonomisë cash.

Në zbatim të Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut do të jenë 101 kritere risku, që parashikohet të zbatohen plotësisht brenda vitit 2024, me përditësimin e modulit të riskut, në bazë të projektit të fiskalizimit dhe të ndërthurjes me modulën aktual. Si fillim, në vijimësi të punës së Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut do të aplikohen vetëm 44 kritere. Do të shikohet në vazhdimësi sa nga këto kritere risku do të realizohen deri në fund të 2024.

Që nga viti 2019, është zbatuar një metodë e bazuar në risk për të përqendruar veprimin e institucioneve në ekonominë informale, në një mënyrë më efektive dhe për ta zhvendosur fokusin larg mobilizimit të të ardhurave shtesë të buxhetit, duke rritur numrin e kontrolleve dhe inspektimeve.

Prej kësaj mase reforme pritet ndikim në konkurrueshmëri. Forcimi i luftës kundër informalitetit në ekonomi do duhet të krijojë një klimë më të mirë të taksimit të drejtë dhe do të rrisë besimin e taksapaguesve ndaj administratës tatimore. Gjithashtu, do të reduktojë konkurrencën e pandershme ndërmjet bizneseve formale dhe atyre informale, do të rrisë të ardhurat dhe, në mënyrë indirekte, fondet e disponueshme për investime në infrastrukturë.

Gjithashtu pritet ndikim në përfundimet sociale si punësimi, ulja e varfërisë, barazia gjinore dhe aksesimi në kujdesin shëndetësor. Kjo masë

reformë kontribuon në konkurrencë dhe do të lejojë gjithashtu, pakësimin e kostos së mbledhjes së të ardhurave. Duke rritur numrin e punonjësve të deklaruar dhe numrin e pagave të deklaruara në nivelin real të tyre, kjo do të kontribuojë indirekt në krijimin e vendeve të punës, taksimin e drejtë dhe sigurimin më të mirë shoqëror për punonjësit. Kjo masë reforme mund të ndikojë pozitivisht në barazinë gjinore, do të rrisë punësimin formal, do të rrisë të ardhurat dhe rrjedhimisht edhe fondet e disponueshme për investime në infrastrukturë dhe për mbulim shëndetësor.

Është e pritshme dhe rritja e motivimit të qytetarëve për të qenë pjesë e luftës kundër informalitetit.

[1] Kapitulli 23 (Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore) dhe Kapitulli 24 (Drejtësia, Siguria, Liria) janë dy kapitujt e Acquis së BE-së që përfshihen në grupimin e kapitujve Themelorë, që do të hapen të parët gjatë procesit të negociatave me Bashkimin Europian dhe do të mbyllen të fundit.

[2] Shqyrtimi i legjislacionit kombëtar në krahasim me nivelin e përafrimit me atë të Bashkimit Europian që bëhet për çdo kapitull të Acquis së BE gjatë procesit të negociatave.

[3] Ministria e Financave, Programi i Reformave Ekonomike: <https://financa.gov.al/programi-i-reformave-ekonomike/>

[4] European Commission, Assesment working document of the Commision on ERP 2022-2024, (20.4.2022 SWD(2022) 120 final), pg. 25
https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-05/Albania%202022%20ERP%20assessment%20SWD_2022_120.pdf

[5] Faqja zyrtare e Ministrisë së Financave:
<https://financa.gov.al/>

[6] Ibid

[7] Raporti vjetor i Komisionit Europian për Shqipërinë 2023.
https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2023_en

[8] Ibid

[9] Ibid

[10] Vendim Nr. 51, datë 26.1.2022 për Miratimin e Programit të Reformave Ekonomike (ERP) 2022–2024

[11] Shqipëria është pjesë e (AEOI) shkëmbimit automatik të informacionit të llogarive financiare, në zbatim të standardit të përbashkët të raportimit dhe marrëveshjes shumëpalëshe të Autoritetit Kompetent për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare. Ligji nr. 4/2020 për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare.

[12] Faqja zyrtare e Drejtorisë së Tatimeve:
www.tatime.gov.al